



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 40/ 2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Laziq dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Arif Butuç kryetar i subjekti politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) me seli në Mamushë, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), lidhur me mos certifikimin e kandidatit për deputet Zymer Zogaj, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**HEDHET** si i palejuar apeli i subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP).

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me nr. Anr.40 më datë 02.06.2017, të paraqitur nga Arif Butuç kryetar i subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) me seli në Mamushë kandidat për deputet nga subjekti politik KTAP, ka paraqitur apel kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 691/2017 dt. 24.5.2017, me të cilin KQZ ka refuzuar certifikimin e kandidatit me numër rendor 4, Zymer Zogajn nga radhët e subjektit politik KTAP, me arsyetimin se i njëjti është nga komuniteti shqiptar dhe jo turk, gjë e cila sipas parashtruesit të apelit bie ndesh me kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Në vazhdim parashtruesi i apelit thekson se lidhur me këtë çështje juridike edhe më parë ka paraqitur apel në PZAP-it dhe PZAP me vendimin Anr.4/2017 të dt. 26.05.2017 ka hedhur poshtë si të palejuar apelin.

Kundër vendimit të PZAP-it parashtruesi i apelit ka ushtruar ankesë, në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykatën Supreme të Kosovës me Aktgjykimin me numër AA-Uzh.nr.2/2017 të datës 30.05.2017, me pjesën e I të dispozitivit, miratohet ankesa e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) me seli në Mamushë.

Me pjesën II të dispozitivit, ndryshohet vendimi i PZAPI-të A.nr. 4/2017 dt. 6.5.2017 .

Me pjesën III të dispozitivit, refuzohet si i pa bazuar ankesa e subjektit politik Turk Adalet Partisi (KTAP) dhe ankesa e kandidatit për deputet Zymber Zogjanit nga data 25.5.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 691/2017 dt. 24.5.2017 .

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejshmërisë së apelit gjeti se:

## **Apeli është i palejuar**

Paneli pas shqyrtimit të apelit gjeti se apeli i parashtruar nga subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) me seli në Mamushë, ka njejtësi subjektive, objektive gjendje të njejtë faktike me apelin e parashtruar nga i njëjti subjekt politik me datë 26.5.2017 kundër vendimit të njëjtë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 691/2017 dt. 24.5.2017 e cila çështje ka përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatën Supreme të Kosovës, AA-Uzh.nr.2/2017 të datës 30.05.2017. Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton se apeli i parashtruar nga Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) është çështje e gjykuar “res iudicata”.

PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e në pajtim me dispozitat e nenit 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 40/2017 më datën 06.06.2017.



### ***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare.